



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:154261

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05754557

PAKR.nr.567/23

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. P. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, dhe përgjigjes në ankesën e prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit av. Sylejman Klinaku, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prizren, PKR.179/22 i datës 14.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPRK-së, më datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prizren, PKR.179/22 i datës 14.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.179/22 të datës 14.07.2023, të akuzuarin A. P., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par. 3 të KPPRK-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari A.P., ka kryer veprën penale që me aktakuzë i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale kanë mbetur në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje apo të ndryshohet dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor sipas propozimit në aktakuzë.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A. P. av. Sylejman Klinaku, me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorisë, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/I.nr.516/23, të dt. 21.09.2023, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, të aprovohet, ashtu që, aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPRK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigje të ankesës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore - DKR në Prizren, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 3 e lidhur me nenin 386 të KPRK-së, të cilat qëndrojnë në faktin se i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, gjegjësisht ato që janë dhënë janë të pa qarta dhe në masë të konsiderueshme në kundërtënie, sidomos, përkitazi me faktet vendimtare, e po ashtu, të njëjtat arsye janë në kundërshtim edhe me përmbajtjen e shkresave - provave të deponuara në këtë çështje penalo-juridike. Kështu, gjithë herë sipas pretendimeve ankimore, theksohet se në rastin konkret është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka përpiluar aktgjykimin në përputhshmëri me nenin 369 të KPPRK-së, ngase, aktgjykimi i ankimuar është kundërtënës dhe atë, sidomos, dispozitivi me arsyetimin e më pastaj, edhe arsyetimi me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, për çka, prokuroria konsideron se lirimi i të akuzuarit nga akuza është i gabuar për arsye se nga provat e paraqitura nga prokuroria rezulton se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën edhe është akuzuar i akuzuari A. P.. Në rastin konkret nga administrimi i provave e sidomos, dëgjimi i dëshmitarëve, duke përfshirë dëshmitarin B. B.,

pastaj, provat materiale si raporti i inspektimit të AFK-së, mbi eksportimin e pajisjeve elektronike, ku, vërtetohet se nga telefoni të cilin e posedonte i akuzuari A. P., është dërguar SMS, në telefonin e dëshmitarit B. B., me përmbajtje “ej mshele se po vijmë kah ti”, e që këtë, pra, e ka bërë me qëllim që të mos gjobitet pronari i lokalit “Vrrini”, që do të thotë se me këtë ka kryer veprën penale për të cilën edhe është akuzuar, mirëpo, përkundër të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë, me aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 364 par. 1 nën par. 3 të KPPRK-së, të akuzuarit i ka liruar nga akuza, prandaj, me vetë faktin që i ka liruar të akuzuarit, gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 10 të KPPRK-së, për çka, edhe domosdoshmërisht aktgjykimi i ankimuar duhet anuluar.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit, av. Sylejman Klinaku, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor pa dyshim që është vërtetuar se i akuzuarit nuk ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, prandaj, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë edhe e ka liruar të akuzuarin, për çka, më tutje, në arsyetimin e përgjigjes në ankesë, vazhdohet me elaborimin e deklaratave të akuzuarit, dëshmitarit por, edhe provave materiale dhe konstatohet se me provat në fjalë, nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë, për çka, edhe i propozojë gjykatës që të refuzohet ankesa e prokurorisë, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, por, as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.10, e lidhur me nenin 369 të KPPRK-së, ngase, aktgjykimi i ankimuar duke përfshirë edhe arsyetimin, është i qartë dhe konkret, po ashtu përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante në këtë çështje penalo-juridike dhe gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare dhe atë qasja ndaj fakteve vendimtare përveç, që ka qenë e drejtë, objektive dhe e ligjshme, po ashtu, ka mbështetje edhe në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe atë në deklaratat e dëshmitarit A. P., pastaj, vetë të akuzuarit A. P., por, edhe provat materiale në shkresa të lëndës, si fletëparaqitja për kundravajtje - dënimi me gjobë në shumë prej 200 €, për pronarin e lokalit “Vrrini”, ku, ka punuar dëshmitari B. B., kontrata e punës për të akuzuarin, që ka punuar përkohësisht si inspektor për AUV të Kosovës, vërtetimi për sekuestrim të SIM kartelës të akuzuarit, raporti i ekspertimit nga AKF-ja, për telefonin 046192723, të cilin e përdorte i akuzuari A. P., vërtetimi për sekuestrim të telefonit të dëshmitarit A. P., ku, vërtetohet përmbajtja e SMS-it, që është dërguar nga telefoni i të akuzuarit A. P., që do të thotë, se gjykata e shkallës së parë, kur, ka aprovuar konkludimet e saja, ka vepruar në frymën e parimeve themelore të KPPRK-së, pra, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin “In du bio pro reo”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij, kurse, në ndërlidhje të kësaj, po ashtu, duke pasur parasysh edhe faktin se të gjitha argumentet që janë In Peius - pra, në disfavor të akuzuarit, duhet të vërtetohen me siguri të plotë, përkatësisht, përtej dyshimit të bazuar dhe nëse nuk arrihet diçka e tillë duhet konsideruar se nuk ekzistojnë kushte për argumentet që janë në disfavor ndaj të akuzuarit, pra, duke respektuar edhe parimin se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të akuzuarit, pra, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të respektimit të parimeve në fjalë edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pra, duke konstatuar se me provat e proceduara nuk mund të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, ngase, për ekzistimin e veprës

penale në fjalë duhet të plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë, çka, me të drejtë, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se në rastin konkret nuk është vërtetuar se si rezultat i dërgimit të mesazheve në fjalë, lokali “Vrrini”, të ketë përfituar përparësi për të mos u gjobitur për shkak të mosrespektimit të masave që kanë qenë në fuqi gjatë pandemisë “Covid19”, për arsye se në bazë të provave - deklaratave të dëshmitarëve por, edhe provave materiale por, edhe fletëparaqitja për kundërvajtje e lëshuar nga AUV, vërtetohet se natën kritike pronari i marketit “Vrrini”, është dënuar me gjobë në shumë prej 200 €, fletëparaqitje kjo e nënshkruar edhe nga i akuzuari me koleget e tij, që do të thotë se mesazhin të cilin e ka dërguar i akuzuari nuk ka arritur efektin e tij, pra, për mos gjobitjen e lokalit në fjalë, por, përkundrazi pronari është i gjobitur dhe lokali është mbyllur, që do të thotë se nuk është shkaktuar pasoja, gjë, që në rastin konkret nuk është vërtetuar se i akuzuarit t’i ketë dërguar personit tjetër, gjegjësisht, dëshmitarit B. B., SMS-së, me qëllim që ta mbyllë marketin e të mos gjobitet, ngase, SMS-i në fjalë as që e ka vërejtur dëshmitari B. B., ndërsa, marketi në fjalë është gjobitur me kundërvajtje, i cili po ashtu, nuk ka qenë fare pronë e dëshmitarit, por, pronë e personit tjetër, i cili edhe është gjobitur për një gjë të tillë, për çka, edhe më pastaj, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në dispozitivin të aktgjykimit të ankimuar.

Pa dyshim, që këtë, gjykata e shkallës së parë, e ka bërë, kuptohet, pasi më parë, ka bërë vlerësimin e të gjitha provave në shkresa të lëndës, e duke marr parasysh së pari vetë deklaratat e të akuzuarit A. P., të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i cili e ka mohuar kryerjen e veprës penale në fjalë, duke deklaruar se i akuzuari A. P., ia ka dërguar një SMS, dëshmitarit në fjalë, për të dalë për të pirë kafe së bashku, ngase, të njëjtin e ka mik, kurse, vetë dëshmitari B.B, ka deklaruar se SMS-in në fjalë as që e ka parë, dhe këtë e ka vërejtur pasi ka ardhur inspektorët së bashku me policinë dhe vetë të akuzuarin dhe e kanë dënuar me gjobë pronarin e lokalit “Vrrini”, ku, edhe ka punuar dëshmitari A. P., dhe se fletëparaqitjen për kundërvajtje e ka nënshkruar vetë i akuzuari së bashku me kolegët e tij, e që faktet dhe rrethanat në fjalë vërtetohen edhe nga provat materiale në shkresa të lëndës, si fletëparaqitja për dënimin me gjobë në shumë prej 200 €, në emër të pronarit të marketit “Vrrini”, e që faktet dhe rrethanat në fjalë janë vërtetuar edhe me provat materiale në shkresa të lëndës, prova këto, nga të cilat nuk vërtetohet asnjë nga elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari është akuzuar me aktakuzën e prokurorisë dhe më pastaj, gjykata e shkallës së parë, ka konkluduar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet se i akuzuari A. P., ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, për çka, edhe e ka liruar nga akuza e prokurorisë të akuzuarin për veprën penale në fjalë. Një konkludim të tillë, gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pasi më parë, ka marr parasysh vetë mbrojtjen e të akuzuarit, i cili e ka mohuar veprën penale në fjalë, pastaj, përveç, deklaratat e të akuzuarit, deklaratat e dëshmitarit B. B., ku, vërtetohet se dëshmitari as që e ka vërejtur SMS-in-mesazhin, të cilin e ka pranuar nga telefoni i të akuzuarit, ndërsa, në mesin e inspektorëve nga të cilët është gjobitur marketi, ku, ka punuar dëshmitari ka qenë edhe vetë i akuzuari, pra, së bashku me dy koleget e tij, që e kanë gjobitur marketin në fjalë, atëherë, gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh edhe parimin themelor në procedurë penale “ In dubio pro reo”, se të gjitha faktet dhe rrethanat e dyshimta interpretohen në favor të akuzuarit, atëherë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se nuk mund të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale, sikur që, pra, konstatohet në dispozitivin e aktakuzës.

Prandaj, konstatimi se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarr ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, është i ligjshëm dhe i drejtë, për çka, më në detaje përkritazi me këtë do të bëhet fjalë gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore edhe përkritazi me gjendjen faktike.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga prokuroria kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se, edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasojë e konkludimeve të aprovuara ka rezultuar me shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarit, ngase, me të gjitha provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet gjendja faktike e kundërt në atë çka, ka vendosur gjykata e shkallës së parë, pra, me aktgjykim lirues, ngase, prokuroria konsideron se në veprimet inkriminuese të akuzuarit janë konsumuar të gjitha elementet e veprës penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, ngase, si rezultat i SMS-it në fjalë, të gjithë pronarët e lokaleve kanë filluar t'i mbyllin lokalet dhe atë pasi kanë pranuar mesazhin nga i akuzuari "Ej mshele se po vim kah ti", që do të thotë se me këtë janë konsumuar elementet e veprës penale keqpërdorimi i informatës zyrtare, ngase, e njëjta ka ndodhur pikërisht në kohën e pandemisë "Covid 19", me ç'rast është rrezikuar edhe jeta e qytetarëve, për çka, rezulton se i njëjti e ka kryer veprën penale, prandaj, me vetë faktin që i akuzuari është liruar, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarit, kur, të njëjtin e ka liruar nga akuza e prokurorisë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar me përputhje me dispozitat e nenit 360 të KPRK-së, kështu që, drejtë i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë në këtë çështje penale - juridike në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe e ka liruar të akuzuarin nga akuza, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së.

Në rastin konkret me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari A. P. ditën kritike ka qenë në vendin e tij të punës dhe për një moment ia ka dërguar një SMS-së dëshmitarit B. B., për të dalë për të pirë kafe, mirëpo, SMS-in-mesazhin në fjalë dëshmitari B. B. nuk e ka vërejtur e as që e ka lexuar, për të cilin e ka kuptuar vetëm pasi për këtë e ka njoftuar policia, e cila ka arritur për pak kohë në vendin e ngjarjes, ku, po punonte dëshmitari B. B., së bashku me policinë ishin edhe Inspektorët e AUV-ut, ku, në mesin e inspektorëve ishte edhe i akuzuari A. P., i cili së bashku edhe me dy inspektor të tjerë, pronarin e marketit "Vrrini", ku, po punonte edhe dëshmitari B.B., e kanë dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 €, për shkak që ka punuar në kundërshtim me masat e caktuara nga Qeveria për shkak të "Covid 19", fakte këto dhe rrethana që janë vërtetuar përveç, nga i akuzuari edhe nga dëshmitari B. B., por, që kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, si fletëparaqitja për kundravajtje për shqiptimin e dënimit me gjobë nga Inspektorit e AUV-ut, ku, në mesin e tyre që e kanë nënshkruar fletëparaqitjen në fjalë është edhe i akuzuarit A. P., pastaj, kontratatën e punës së përkohshme për të akuzuarin A.P. si inspektor gjatë kohës kritike, SMS-in e telefonit, të dërguar nga i akuzuari, por, edhe të pranuar nga dëshmitari B. B., ekspertiza e AKF-Së, përkitazi me telefonat në fjalë, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, ku, në bazë të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, atëherë, me të drejtë gjykatës e shkallës së parë, ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, sikur që konstatohet në aktakuzën e prokurorisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht, faktet jo kontestuese, që u çekën më lartë, pastaj, se me asnjë fakt apo rrethanë nuk vërtetohet se i akuzuari të ketë lajmëruar dëshmitarin për kontrollën që do të bëhej nga Inspektorët e AUV, atëherë, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet e të akuzuarit A. P., nuk përmbushen elementet e veprës penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, është i drejtë dhe i logjikshëm që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe Ligji Penal dhe nuk ka as shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarit sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i informatës nga neni 416 par. 1 të KPRK-së, ngase, përveç, pretendimeve në aktakuzë, se i akuzuari e ka njoftuar dëshmitarin B. B., për inspektimin që do t'i bëhet lokalit ku ishte duke punuar dëshmitari, me asnjë provë në shkresa të lëndës, por, as tani me ankesë, prokuroria nuk ka ofruar ndonjë provë që do të argumentonte pretendimin si në aktakuzë, atëherë pretendimet ankimore të prokurorisë se i akuzuari është dashur të shpallet fajtor për këtë vepër penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova dhe në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.567/2023, të dt. 30.05.2024

Procesmbajtës,
Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,
1.Xhevdet Abazi

Kryetar i kolegjit,
Hashim Çollaku

2.Zyhdi Haziri

Numri i lëndës: 2022:154261
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05754557